

Gjykata Supreme e Kosovës / kolegji i përberë nga gjyqtarët: Enver Peci, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Emine Kaçiku, anëtar; me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në kontestin administrativ të paditësit M. A. C. nga Prizreni, kundër të paditurës, K. P, me bazë juridike anulimi i aktit administrativ-tatimi mbi pronën, lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr.292/2015, datë 24.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28.04.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësit M. A. C. nga Prizreni, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr.292/2015, datë 24.11.2015.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e atakuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr.292/2015, datë 24.11.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit M. A. C., nga Prizreni, dhe është vërtetuar aktvendimin i Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1018/2013, datë 02.09.2015.

Paditësi i ka parashtrua kësaj Gjykate brenda afatit ligjor kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston në tërësi ligjshmërinë e aktvendimit të mësipërm për shkak të vendimit jo të drejtë, shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, shkeljes së të drejtave të njeriut dhe për shkak të diskriminimit, me propozimin që të aprovohet kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit, AA.nr. 292/2015, datë 24.11.2015, të ndryshohet dhe ai të lirohet nga pagesa e taksave gjyqësore.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, mbajti seancën e kolegjit dhe, pas vlerësimit të aktvendimit të goditur dhe kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë si dhe shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, konstatoi:

Kërkese është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë çështje administrative paditësi ka kërkuar të lirohet nga pagesa e taksave gjyqësore, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, sipas parashtrësve –vërejtjeve të dërguara nga gjykata e shkallës së parë në bazë të udhëzimit administrativ 2008/02 “Për unifikimin e taksave gjyqësore”. Gjykata e

Apelit, me aktvendimin AA.nr.292/2015, datë 24.11.2015, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit M. A.C. nga Prizreni dhe e ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore Prishtine-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1018/2013, datë 02.09.2015.

Lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të kontestuar, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve të ngritura në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dytë drejt ka vepruar kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e palës së paditur dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Sipas nenit 7.2 të udhëzimit administrativ 2008/02 “Për unifikimin e taksave gjyqësore”, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin nr.20/2012 dhe nr.37/2012, është përcaktuar se një person mund të lirohet nga pagimi i taksës gjyqësore, nëse ofron dëshmi se është përfitues i ndihmës sociale nga MPMS ose është duke marrë ndihmë ligjore falas nga Zyra e Qarkut për Ndihmë Ligjore.

Gjykata Supreme, mbasi i vlerësoi pretendimet e paditësit të ngritura në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, vlerësoi se ato në këtë çështje administrative nuk kanë ndikim në marrjen e një vendimi tjetër nga ana gjykatave të instancave më të ulëta, pasi që neni 7.2 i udhëzimit administrativ 2008/02 “Për unifikimin e taksave gjyqësore” i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimet nr.20/2012 dhe nr.37/2012, është i qartë, ndërkaq paditësi nuk ka dëshmuar se është përfitues i ndihmës sociale ose është duke marrë ndihmë ligjore falas nga Zyra e Qarkut për Ndihmë Ligjore. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të nevojshme mbi faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Nga sa u tha me sipër, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Më 28 prill 2016, ARJ.nr.14/2016

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Enver Peci